

## **GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**

**CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/2013**

**30 korrik 2013**

**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS** në instancë të parë nëpërmjet gjyqtares së EULEX-it, gjyqtares ROSITZA BUZOVA në lëndët të propozuesve A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S., të gjithë nga fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit të përfaqësuar nga avokati A. A. K. nga Prishtina kundër kundër propozuesit QRK dhe MMPH, me përfaqësues ligjor MD për përcaktimin e kompensimit për shpronësime të pronës së paluajtshme me propozim të ushtruar për masat e sigurisë në pajtim me nenin 387, paragrafi 1, pika h), neni 297 dhe nenit 306 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-006 të procedurës kontestimore (Gazeta Zyrtare nr. 38/2008) e ndryshuar dhe e plotësuar me anë të Ligjit nr. 04/L-118 (Gazeta Zyrtare nr. 28/2012) (“LPK”) i lidhur me nenin 3 të Ligjit nr. 03/L-007 të procedurës jo kontestimore (Gazeta Zyrtare nr. 45/09) (“LPJ”) dhe neni 39, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-139 mbi shpronësimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare nr. 52/09), e ndryshuar dhe e plotësuar me anë të Ligjit nr. 03/L-205 (Gazeta Zyrtare nr. 91/10) (“LSHPP”) në seance të mbyllur të mbajtur me 30 korrik 2013 nxjerr si në vijim

### **A K T V E N D I M**

**I.** Nëpërmjet kësaj BASHKOHEN lëndët CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës në një seance dhe procedura të njëjtë dhe nxjerrja e aktgjykimit të vetëm ndaj tyre në pajtim me nenin 408 të LPK-se i lidhur me nenin 3 të LPJ-se.

**II.** Pjesërisht MIRATOHET propozimi për masat e sigurisë i ushtruar më 11 korrik 2013 në lëndët CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës nga avokati A. A. K. nga Prishtina në emër të paditësve në këto lende të bashkuara të A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S., të gjithë nga fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit.

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

**III. SHQIPTOHET MASA E PËRKOHSHME E SIGURISË** duke i ndaluar kundër propozuesit QRK dhe MMPH–Prishtinë si palët duke kundërshtuar sigurimin dhe çdo person i trete që të demolojnë shtëpinë banuese pesë katësh që gjendet në parcelën kadastrale nr.152-0, e regjistruar në Certificate për të drejtat e pronës së paluajtshme Nr. UL-72614046-00002, Zona Kadastrale Mazgit, Komuna e Obiliqit deri sa kushtet e parapare me ligj për zbrazjen e saj të plotësohen plotësisht si në vijim:

1. Vendimi final mbi shpronësimin e kësaj prone është miratuar në pajtim me nenin 11 paragrafët 1-3 të LSHPP-se në baze të vendimit paraprak të lëshuar me herët në nenin 10 të LSHPP-se për ndryshim valid të pronësisë se tij në nenin 11 paragrafi 8 i lidhur me nenin 26 të LSHPP-se;

2. kompensimi i specifikuar në vendim final përkatës për shpronësim të pronës së lartcekur është paguar plotësisht në emër të pronareve të dëmtuar dhe zotëruesve të interesit në pajtim me nenin 16 të LSHPP-se, duke përfshirë 7% të interesit vjetor që do të rrjedh ndërmjet datës efektive të vendimit final dhe datës së pagesës;

3. ka skaduar periudha kohore prej 20 ditëve kalendrike të përshkruar në nenin 11 paragrafi 9 në paragrafi 1 të LSHPP-se, për lirimin e kësaj shtëpie banuese nga dita e pagesës së kompensimit të specifikuar në vendimin final në pajtim me nenin 16 të LSHPP-se; dhe

4. të gjithë banoret të shtëpisë së cekur të përdorur si banim të tyre iu është siguruar akomodim i përkohshëm në pajtim me nenin 20 të LSHPP-se.

**IV. Masa e përkohshme e sigurimit e shqiptuar me anë të pikës III do të mbetet në fuqi deri në lëshimin e aktvendimit të ri mbi masat e sigurisë nga kjo gjykatë.**

**V. Propozimi për masat e sigurisë i ushtruar për lëndet CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës më 11 korrik 2013 nga paditësit A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. është REFUZUAR si i pabazuar në pjesën e mbetur për ndalimin e shkatërrimit të shtëpisë banuese të lartcekur deri sa kompensimi për shpronësim të goditur në këtë procedurë do të vendoset përfundimisht.**

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

**VI.** Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij aktvendimi në pajtim me nenin 310, paragrafi 4 dhe 5 të LPK-se i lidhur me nenin 3 të LPJ-se.

**VII.** Kopja e këtij aktvendim duhet të dorëzohet Stacionit Policor në Obiliq për zbatimin e tij si pjese e masave të shqiptuara të përkohshme të sigurisë.

**VIII.** Propozimi i CN.nr.249/13 së Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe ankesa në CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës duhet të dorëzohet në 5 kopje tek kundër propozuesit për përgjigje në afat kohor prej 30 dite pas pranimit të së njëjtës në pajtim me nenin 36 paragrafi 4 dhe 5 të LSHPP-se.

**IX.** Nëpërmjet kësaj obligohet MMPH në baze të nenit 216 paragrafi 1, nenit 218 paragrafi 1 *in fine* LPJ-se dhe nenit 332 të LPK-se i lidhur me nenin 3 të LPJ-se të prezantoj në gjykatë brenda afatit ligjor prej 3 ditëve dosjen e plote administrative mbi shpronësimin e parcelave kadastrale nr.149-0, nr.150-0, nr.152-0, ZK Mazgit, Komuna e Obiliqit, duke përfshirë, *inter alia*, vendimin paraprak nën nenin 10 të LPP-se të gjitha anekset, tabela, kopjet të planit, raportet të vlerësimit mbi vendimin final nën nenin 11 të LPP-se, dokumentet bankare për kompensimin e paguar nën nenin 16, paragrafi 2 i LSHPP-se, deklaratën e BQK-se për llogarinë e mirëbesimit të hapur në emër të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të pronës së paluajtshëm të lartcekur nën nenin 16, paragrafi 3 të LSHPP-se, me strukture të shumës së depozituar – kapital dhe interesi i rrjedhur, dhe të gjitha dokumentet për akomodim të përkohshëm nën nenin 20 të LPP-se për të gjithë banoret të shtëpisë banuese në parcelën nr.152-0, ZK Mazgit, duke përfshirë edhe anëtar të mitur të familjes.

**X.** Të gjithë palëve ju jepet afati kohor prej 7 ditëve pas pranimit të këtij aktvendimi që të specifikojnë të gjitha provat që duhet të sigurohen me urgjencë në këtë procedurë në pajtim me nenin 379 -381 të LPK-se e lidhur me nenin 3 të LPJ-se.

### **ARSYETIMI**

1. Më 19 dhjetor 2012, A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. si trashëgimtar ligjor të të ndjerit F.H. S., ish nga fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit kanë ushtruar në Gjykatën

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

Supreme të Kosovës një ankese kundër Vendimit Nr. 03/100 i QRK i datës 12 Nëntor 2012 në pjesën e shpronësimit së pronës së paluajtshme në pronësi të F. H. S. për ndërtime të auto udhës Vërmicë - Merdarë, Sektori 9, ZK Mazgit, Komuna e Obiliqit. Vendimi është sulmuar për pasoja formale të dispozitivit të tij dhe arsyetimit në nenin 77, 84 dhe 85 të LPA, në kundërshtim me të gjitha kërkesat të nenit 11 të LSHPP-se, mos vlerësimit të pjesëve shtese dhe frutave të prekura nga shpronësimi – 2 bunar të ujit, 1 ahurë, 100 lisa, dhe objekti i biznesit në katin për dhese të shtëpisë banuese në parcelën kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit, përcaktim i kompensimit për këtë shtëpi dhe pjesë të shpronësuar të tokës bujqësore në parcelat kadastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit, në çmim të tregut real në kundërshtim me nenin 15 të LSHPP-se. Kërkesa është që gjykata të ndryshoj me anë të aktgjyqimit të tyre këtë vendim final duke përshtatur shumën e duhur të kompozimit të shpronësimit.

2. Ankesa e lartcekur në fillim është regjistruar si A.nr.1535/2012 e Gjykatës Supreme të Kosovës në procedurë administrative të konfliktit në nenin 36 të LSHPP-se. Në bazë të vendimit të seancës së përgjithshme të Gjykatës Supreme të Kosovës e miratuar me 15 janar 2013 në pajtim me nenin 23, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-199 mbi gjykata (Gazeta Zyrtare Nr. 49/11) për aplikim unik të ligjit, ky rast është referuar në Gjykatën Themelore të Prishtinës si gjykate kompetente që të vendos në procedurë jo kontestimore në pajtim me nenin 216 të LPJ-se, në kuptim të lokacionit të pronës së patundshme me kompensim të shpronësimit që të rregullohet në territorin e komunës së Obiliqit, e përfshirë në regjionin e saj legjitim në nenin 9, paragrafi 2, nën paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-199 mbi gjykata. Pas referimit me 10 qershor 2013 rasti është regjistruar si CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

3. Në ndërkohë me 3 Prill 2013, A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. kanë ushtruar kundër QRK - MMPH si kundër propozuesit propozimin drejtpërsëdrejti në Gjykatën Themelore të Prishtinës për vërtetimin e kompensimit real të pronës së patundshme të shpronësuar me anë të Vendimit Nr. 03/100, të datës 12 nëntor 2012. Këta të fundit janë specifikuar si objektet banimi, kopshtet dhe tokat bujqësore me ankesat se në vlerësim nuk janë përfshirë dy bunarë uji, një ahurë, 100 lisa, dhe objekti i biznesit në

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

katin përdhese të shtëpisë banuese 5 katesh, rrethojat dhe shtyllat, gjersa të gjitha vlerësimet të bëra nuk janë bazuar në çmimin e tregut në kundërshtim me nenin 15 të LSHPP-se. Propozimi më tej nënvizon se të gjitha pronat e shpronësuar që gjenden pranë rrugës së asfaltit Prishtina – Mitrovica, ndërmjet Mazgitit dhe LLazareves ku do të kalojë auto Vërmicë – Merdarë me infrastrukture adekuate, do duhej të ishin vlerësuar si troje në nivel të pronave pranë auto udhës Prishtinë - Shkup - 10 000 € për 1 ari. Në vend të kësaj e tere sipërfaqja e shpronësuar është vlerësuar si tokë bujqësore në çmim minimal prej 25€, 30€ dhe 42€ për 1 m<sup>2</sup>. Kërkesa është që gjykata nëpërmjet eksperteve të gjeodezisë, në fushën e inxhinierisë civile, agronomi dhe pemëtari të përcaktojnë kompensimin real për pronat e patundshme të shpronësuara.

4. Procedura jo kontestimore e iniciuar nga propozimi në pikën 3 të lartcekur është regjistruar si CN.nr.249/2013 të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

5. Me anë të Aktvendimit ref.nr.2013.OPEJ.0293-004 të Zëvendës kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 11 korrik 2013, konform nenit 5 paragrafi 1, pika c), nën pikat (ii) – (iii) dhe paragrafi 7 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetenca, përzgjedhje dhe caktimi i lendeve të gjyqtar dhe prokuror të EULEX-it në Kosovë (Gazeta Zyrtare No. 27/08), CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës janë marrë përsipër nën kompetencë të gjyqtarëve të EULEX.

6. Nga kjo janë dy procedurat në zhvillim në të njëjtën instance të gjykatës, që i përfshinë palët e njëjta, në baze të fakteve dhe bazave të njëjta ligjore, pjesërisht e përkojnë njëra tjetrën në çështjet e tyre lëndore dhe pjesërisht ndryshe lidhur me bazat mbi sulmimin e kompensimit të përcaktuar dhe demet e lidhura me shpronësim të përfshihen në ato të pretenduara. Pasi që rastet janë në pritje në një të njëjtën fazë dhe njëjtë me asnjë seance dëgjimore të mbajtur, bashkimi i tyre do t'i shmangë vonesat jashtë duplikimit formal të veprimeve procedurale dhe po ashtu do të minimizojë shpenzimet procedurale të palëve në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 i LPK-se, i lidhur me nenin 3 të LPJ-se. CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës duhet të bashkohen ashtu që të dëgjohen në një të njëjtën procedurë

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

---

dhe te vendoset me një aktgjykim në pajtim me nenin 408 te LPK-se e lidhur me nenin 3 te LPJ-se.

7. Më 11 korrik 2013, propozimet identike për masat e përkohshëm të sigurisë janë ushtruar ne CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës nga propozuesit A., B., N. dhe D. S.. Si rrjedhojë e bashkimit të lendeve të procedurës kryesore për përcaktim te kompozimit të shpronësimit, procedura plotësuese e sigurimit nen nenin 306 te LPK-se e lidhur me nenin 3 te LPJ-se ne këto dy raste po ashtu duhet të bashkohet dhe të vendoset me anë të aktvendimit aktual.

8. Në propozim për masat e sigurisë të ushtruar me 11 korrik 2013 ceket se kompensimi për shkak të shpronësimit të pronës nuk është vërtetuar saktësisht me anë të Vendimit Nr. 03/100, i datës 12 nëntor 2012 – sipërfaqet e parcelës kadastrale janë zvogëluar; zonat e banimit të shtëpisë nuk janë matur si duhet dhe rrethoja nuk është konsideruar fare; kati përdhese nuk është vlerësuar si objekt biznesi dhe podrumi – si depo; janë hequr po ashtu objektet shtese dhe lisat – pjese e kompensimit si pjese plotësueses dhe pemët në pronën e shpronësuar, kjo e fundit është vlerësuar nen çmimin real të vlerës së tregut. Në procedure mbi sigurimin e provave nen nenin 385 te LPK-se e lidhur me nenin 3 te LPJ-se e iniciuar nga CN.nr.308/13 të Gjykatës Themelore të Prishtinës nga A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. propozimi i tyre për masat e përkohshme të sigurisë është miratuar me anë të aktvendimit të datës 21 qershor 2013 duke i ndaluar ndërtimet dhe çdo aktivitet tjetër në parcelën nr.152-0, ZK Mazgit. Megjithatë, është hequr 7 dite pas kësaj me ane te aktvendimit te datës 28 qershor 2013 me arsyetim se të gjitha provat e propozuar janë siguruar dhe CN.nr.308/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës është finalizuar. Në këtë mënyrë situata është bere kritike sikurse qe ishte i pashmangshëm rreziku, ndërtimi i shtëpisë me një përkushtim afatgjate, përpjekje dhe investime tani e përdorur si objekt banimi i 4 familjeve me 12 anëtar (të mitur dhe po ashtu të moshuarit), që të shkartohet në ditët vijuese. Në rast të shkatërrimit të saj të gjithë këta njerëz do të mbesin në rrugë pa zgjidhje pasi që nuk është bere kompensimi dhe nuk ka ndonjë strehim alternativ i siguruar nga organet e shpronësimit. Përveç kësaj, ndërtesa, nëse njëherë shkatërrohet

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

nuk mund të vlerësohet si duhet me të gjitha karakteristikat e saja dhe vërtetimit të kompensimit adekuat të saj do të pengohen. Vazhdimi i ndërtimit në parcela nr.149-0 dhe nr.150-0 nëse nuk ndalohen do të pengojnë masat e tyre dhe vlerësimin real në baze të vlerës së tregut. Sigurimi është i nevojshëm që të parandalohet eskalimi i situatës në kuptim të shkatërrimit, lidhjes së palës se kundërt dhe të shmangies së konflikteve të reja serioze. Kërkesa e gjykatës si plotësisht e formuluar është që të shqiptojë masën e shqiptimit duke parandaluar QRK, MMPH, “të shkatërroj shtëpinë pese katesh në parcelën kadastrale nr.152-0 deri në një vlerësim real nga ekspertiza e ndërtimit dhe te beje matje të sakte të parcelave kadastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, dhe kështu të beje vlerësimin e saj real ne baze të çmimeve të tregut deri sa te përfundoj kontesti mbi kompensimin e tyre.”

9. Propozimi për masën e sigurisë i ushtruar me 11 korrik 2013 me përmbajtje të plote identike në CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës është i pranueshëm. Në *vend të parë*, masa e përkohshme e sigurisë e rregulluar sipas kapitullit XXI te LPK-se mund të aplikohet në procedure të veçantë për vërtetimin e kompensimit për pronat të shpronësuara nen nenin 36 te LSHPP-se dhe neneve 215-222 te LPJ-se, në baze të rregullës se përgjithshme subsidiare të nenit 3 te LPJ-se, duke mos qene i cenuar nga ndonjë dispozite e këtij Ligji apo LSHPP-se, qarte duke ndaluar një aplikim tille. Për me tepër nevoja e sigurisë mund të ndodhe për këtë qellim te të gjitha llojeve te mbrojtjes ligjore, duke përfshirë edhe atë te kërkuar ne baze të nenit 36 te LSHPP-se dhe nenit 1 te LPJ-se. Në *rend të dytë* në pajtim me nenin 3 te LPJ-se sigurimi propozohet gjate kursit të zhvillimit të procedurës CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Në *rend të tretë* në pajtim me nenin 296 paragrafi 1, fjalia e pare e LPK-se e lidhur me nenin 3 te LPJ-se, duke pasur juridiksionin e instancës se pare në raste të bashkuara, Gjykata Themelore e Prishtinës po ashtu është kompetente që të vendos propozimin e sigurisë të ushtruar tek ata. Në *rend të katërt* këta të fundit janë dorëzuar në forme të shkruar të përshkruar nga neni 304 paragrafi 1, fjalia e partë e LPK-se e lidhur me nenin 3 të LPJ-se, me përmbajtje nen nenin 304 paragrafi 3 e LPK-se e lidhur me neni 3 te LPJ-

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

se, e nënshkruar nga avokati A.A. K. si përfaqësues i autorizuar i A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. në baze të autorizimit të datës 10 korrik 2013.

10. Ky propozim i sigurisë i datës 11 korrik 2013 duke qene proceduralisht i lejuar, pjesërisht është i bazuar në baze të meritave të tij. *Në vend te pare*, procedura për vërtetim te kompensimit të pronës së patundshme te të ndjerit F. H. S., e shpronësuar me ane të Vendimit Nr. 03/100 te qeverise se Republikës se Kosovës i datës 12 nëntor 2012 ishte iniciuar me 19 dhjetor 2012, në afate kohor prej 30 ditëve i përshkruar sipas nenit 36 paragrafi 3, fjalia e pare e LSHPP-se pasi ka hyre ne fuqi konform nenit 11 paragrafi 7 i LSHPP-se me publikimin e tij ne Gazetën Zyrtare Nr. 33/12 më 23 nëntor 2012. Ose procedura kryesore nuk mund të ndërpritet për shpronësim të këtij afatit ligjor konform nenin 36 paragrafi 3, fjalia e pare e LSHPP-se. *Në vend te dyte*, kompensimi për pronat e shpronësuara atakohet ne këtë procedure D. S. si pronar i tyre–trashëgimtar ligjor i F. H. S. për parcelat kadastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, Certificate Nr. UL-72614046-00002, ZK Mazgit, në baze të trashëgimisë se rregulluar me anë të Vendimit Nr. rendor LPR-104/2013 Nr. ref. LRP-50/2013 e lëshuar nga Noteri N. RR. në Obiliq më 14 Shkurt 2013. Sa i përket paditësve të tjerë A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. duke qene banore të shtëpisë e cila gjendet në parcelën kadastrale nr.152-0 ata e kane statusin e *zotëruesve të interesit* sikurse që përcaktohet ligjërisht me anë të nenit 2, paragrafi 1 i LSHPP-se. Ose legjitimiteti aktiv i kërkuar nga neni 36 paragrafi 1 i LSHPP-se bazohet në *pronësinë* e pretenduar të pronave të shpronësuara lidhur me D. S. dhe *interes ligjor*, tjetër përveç pronësisë, lidhur me A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. *Në vend te trete* nuk ka pengesa nen nenin 391 te LPK-se i lidhur me nenin 3 te LPJ-se dhe/ose me te ndonjë tjetër, duke përjashtuar pranueshmerine e rasteve te bashkuara. Kështu qe nxjerrja e aktgjykimit ndaj tyre konform nenin 36 paragrafi 6 i LSHPP-se dhe nenit 220 te LPJ-se është i lejueshëm, gjersa *pasojat e saja te ardhshëm ligjore dhe zbatimi mund te sigurohet*. Ky parakusht i pare për miratimin e sigurisë është plotësuar.

11. Në pajtim me nenin 297, paragrafi 1 pika a) e LPK-se, e lidhur me nenin 3 te LPJ-se *paditësit e kane provuar propozimin e tyre për vërtetimin e kompensimit mbi*



**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

*shpronësimin* në CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës me a) Vendimin Final të bashkangjitur Nr. 03/100 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 12 nëntor 2012, dhe raportin e vlerësimit të Ministrisë së Financave të datës 6 shtator 2012 për parcelat nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit b) sigurimi i provave në CN.nr.308/13 e Gjykatës Themelore të Prishtinës të inkuorporuar me procesverbal për marrjen e tyre në CN.nr.249/13 dhe CN.nr.467/13 në pajtim me nenin 385 të LPK-se e lidhur me nenin 3 të LPJ-se. Provat të përmendura në këtë fazë të procedure fillestare përmbajnë të *dhënat që tregojnë ekzistimin e se drejtës për rregullimin e kompensimit mbi shpronësimin si në të*, duke dhënë si shembull dallimin në sipërfaqe totale të shtëpisë 5 katesh në parcelën kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit e vendosur në procedure të shpronësimit si 955 m<sup>2</sup> dhe me ekspertize ligjore të datës 24 qershor 2013 - 1 398.01 m<sup>2</sup> e kombinuar me mospërputhje në vlerësim të disa dëme të drejtpërdrejta lidhur me shpronësimin. Kështu që propozimi që kompensimi të rregullohet nga gjykata deri tani është mbështetur në një masë rastësie e cila kënaq standarde të sigurisë të parapare me anë të nenit 297, paragrafi 1, pika a) e LPK-se, i lidhur me nenin 3 të LPJ-se.

12. Parakushti tjetër është nevoja e sigurimit dhe interesi ligjor në të. Është e formuluar nga neni 297, paragrafi 1 pika b) e LPK-se e lidhur me nenin 3 të LPJ-se duke cekur se *masa e sigurisë mund të urdhërohet nëse ekziston rreziku se pa urdhërimin e tij pala kundërshtarë mund të kërkojë zbatimin e aktgjykimit, duke i pamundësuar apo dukshëm vështirësuar, posaçërisht duke ndryshuar gjendjen ekzistuese apo përndryshe në mënyrë të kundërt duke prekur të drejtat e personit i cili propozon sigurimin*. Këtu masa e propozuar e sigurimit për parandalim të shkatërrimit e shtëpisë në parcelën kadastrale nr.152-0, ZK Mazgit është e *nevojshme* për të siguruar deri sa të gjitha kërkesat ligjore plotësohen me kohe mbi zbrazjen e shtëpisë banuese të shpronësuar. Në vend të *pare* në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, fjalia e *pare* e LSHPP-se organi i shpronësimit duhet të miratojë vendimin final duke aprovuar apo refuzuar kërkesën e shpronësimit gjatë periudhës kohore prej 12 muajsh që fillon me datën e ndodhjes 15 dite pas ditës efektive të vendimit paraprak përveç nëse zgjatet në pajtim me nenin 11, paragrafi 2 i LSHPP- për kohëzgjatje e instancës së

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

pare dhe/ose instancën e dyte të procedurës gjyqësore nen nenin 35 te LSHPP-se. Per argumentum ad contrario të nenit 11, paragrafi 1, fjalia e pare dhe paragrafi 3, instanca e pare te LSHPP-se, organi i shpronësimit nuk ka pushtet që të miratoj vendimin final duke prekur të drejtat pronësore pa vendimin paraprak efektiv dhe ligjor dhe juridikisht të pa ankimuar në legjitimitet të shpronësimit nen nenin 10 të LSHPP-se. E njëjta vlen nga neni 3, paragrafi 1, fjalia e dyte e LSHPP-se duke cekur se pushteti i organit të shpronësimit për te shpronësuar prone të patundshme duhet të jete rreptësishtë pjese e kufizimeve, procedurave, rregullave dhe kushteve të specifikuar në Ligj. Në këtë rast Nr. 03/100 i QRK i datës 12 nëntor 2012 nuk është evidentuar si i nxjerr në pajtim me nenin 11, paragrafi 1 i LSHPP-se ne baza të vendimit paraprake efektiv dhe juridikisht të pa ankimuar nen nenin 10 te LSHPP-se të legjitimitetit të shpronësimit në fjalë me qellim të verifikimit të transferimit të pronësisë private mbi parcelat nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit në prone publike në pajtim me nenin 4, paragrafi 5 i LSHPP-se. *Në vend te dyte*, në pajtim me nenin 11, paragrafi 8, fjalia e pare e LSHPP-se, nëse vendimi final e autorizon shpronësimin, atëherë nuk do duhej të kishte ndryshime në pronësi apo të drejtat të tjera të personit apo pronës se caktuar nuk *duhet të jene të ndikuara apo zbatuara deri në pagim të plotë të kompensimin të kërkuar me anë të këtij vendimi final në pajtim me nenin 16 të LSHPP-se*. Sipas nenit 11, paragrafi 8, fjalia e dytë e LSHPP-së vetëm pas pagesës së saj prona përkatëse do të regjistrohet në emër të Republikës së Kosovës nëse Organi i Shpronësimit është Qeveria e saj. Personat e tjerë që kanë në pronësi apo në posedim pronën përkatëse nuk do të kërkohet të lirojnë apo dorëzojnë në rast se shtëpia në mënyrë aktive përdoret për qëllime të banimit apo të biznesit derisa 20 ditë të kenë kaluar nga data në të cilën kompensimi në Vendimin përfundimtar të jetë paguar në pajtim me nenin 16 të LSHPP-së – Neni 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së apo në rast të ndonjë prone tjetër 10 ditë kanë kaluar – Neni 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së. Autoriteti i Shpronësimit është i obliguar të paguaj shumën e kompensimit në Vendimin Përfundimtar Pronarëve të prekur dhe Zotëruesve të Interesit – Neni 16, paragrafi 2, fjalia e parë e LSHPP-së, duke përfshirë shumën e përcaktuar në vlerësimin përkatës – Neni 16, paragrafi 2,

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

fjalìa e dytë, nën paragrafi 1 i LSHPP-së plus interesi statutor përkatës në këtë rrjedhë ndërmjet datës efektive të Vendimit Përfundimtar të shkallës prej 7% interes i thjeshtë vjetor – Neni 16, paragrafi 2, fjalìa e dytë, nën paragrafi 2 , fjalìa e dytë, nën paragrafi 2 i LSHPP-së. Nëse një person refuzon pranimin e këtij kompensimi, mjetet do të depozitohen në një xhirollogari mirëbesimi në BQK dhe shuma e depozituar do të konsiderohet “e paguar” për qëllime të këtij ligji – Neni 16, paragrafi 3 i LSHPP. Nëse një person ankimohet në Gjykatë sipas Nenit 36 të LSHPP-së shuma e kompensimit të paraparë me vendimin Përfundimtar dhe aktgjykimi për rritje të saj, Organi Shpronësues do të paguaj një kompensim shtesë – Neni 16, paragrafi 4 i LSHPP-së. Përderisa Neni 16, paragrafi 5, fjalìa e parë e LSHPP-së përcakton kompensimin në Vendimin Përfundimtar për t’u paguar brenda 2 viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, mos pagesa në këtë afat i jep të drejtë personit për të cilin nevojitet pas skadimit të saj të paraqes ankesë pranë gjykatës për të revokuar apo anuluar një vendim të tillë – Neni 16, paragrafi 5, fjalìa e dytë e LSHPP. Kur i nënshtrohet rrethanave në këtë rast këto dispozita përjashtojnë ndryshimin mbi shtëpinë e ndërtuar në ngastrën katastrale nr. 152-0, ZC Mazgit për t’u ndryshuar – Neni 11, paragrafi 8 i LSHPP-së për t’u ndikuar/ apo zbatuar dhe kjo shtëpi e banimit të lirohet–Neni 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së *pa pagesë të kompensimit* në Vendimin Përfundimtar plus 7% e interesit vjetor të akumuluar–Neni 16, paragrafi 2 i LSHPP-së, pronarit (pronarëve) dhe Zotëruesit/Zotëruesve të interesit që kanë të drejtë të pranojnë atë apo pas refuzimit të saj duke vendosur shumën e duhur në një llogari mirëbesimi në emër të tyre në BQK – Neni 16, paragrafi 3 i LSHPP-së. Në rast se nuk ka ndonjë dëshmi të vetme që kompensimi i specifikuar në Vendimin Nr. 03/100 të datës 12 nëntor 2012 për shpronësim të pronave të F. H. S. është paguar në ndonjë moment tek pasardhësi/pasardhësit i tij ligjor në pajtim me Nenin 16, paragrafët 2 dhe/apo 3 të LPP. Pa këtë pagesë e drejta e pronësisë mbi këto prona nuk ka mundur të konsiderohet e bartur sipas Nenit 11, paragrafi 8 i LSHPP-së, përderisa posedimi i tyre nuk ka mundur të merret sipas Nenit 11, paragrafi 9 i LSHPP-së. Me parashtrësën e parashtruar më datën 26 korrik 2013 në rast se përfaqësuesi i paditësve avokati A. A. K. ka marrë pjesë në njoftimin e lëndës ref.nr. 2073 të Ministrisë së

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

Infrastrukturës të datës 24 korrik 2013 për S. (H.) S. për lirim të ngastrave katastrale nr. 150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit brenda 5 ditëve pas pranimit të saj më 25 korrik 2012. Në bazë të këtij njoftimi kompensimi i duhur për shpronësim të tyre ishte paguar më datën 18 qershor 2013 – dokumenti përkatës i bankës nuk është bashkëlidhur për të verifikuar që kapitali dhe shkalla e interesit janë transferuar; edhe pse të prekura nga pagesa nuk është e vlefshme sipas Neni 16, paragrafi 3 i LSHPP-së duke qenë në emër të S. (H.) S. – i afërm i paditësve (xhaxhait në anën e babait) por përndryshe pronar i ngastrave katastrale nr.154-1 dhe nr.155-1, ZK Mazgit, i prekur nga shpronësimi në këtë zonë, por gjendet matanë rrugës, larg nga ngastrat katastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit, duke qenë ndryshe nga ato dhe jo në fqinjësi me ato. Pasi që S. (H.) S. është pa të drejta dhe/apo interesa në ngastrat katastrale nr. 149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, ZK Mazgit çdo pagesë në favor të tij nga Organi Shpronësues është pa efekt juridik në lidhje me A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. *Së pari*, ajo e kundërshton Nenin 16, paragrafin 2 të LSHPP-së duke kërkuar që kompensimi i shpronësimit të paguhet tek *pronarët dhe Zotëruesit e interesit të prekur dhe anasjelltas* jo personave pa të drejta apo interesa në pronat përkatëse. *Së dyti*, ajo e kundërshton gjithashtu Nenin 305, paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 29/78, pa ndryshime № 39/85, 45/89, 57/89 dhe Gazeta Zyrtare e RFJ-së Nr.31/93) (“LMD”) në bazë të së cilës përmbushja e çdo detyrimi duhet të *ketë ndikim tek kreditori apo tek personi i përcaktuar me ligji, vendimi gjyqësor, kontrata ndërmjet kreditorit dhe debitorit, apo kreditori vet.* Nuk ka provë në rast që pagesa e treguar në Njoftimin ref.nr.2073 të Ministrisë së Infrastrukturës, e datës 24 korrik 2013 ishte ndikuar më 18 qershor 2013 për S (H) S si person, i autorizuar për të pranuar atë në emër të A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. bazuar në përcaktimit të ndonjë baze alternative sipas Nenit 305, paragrafi 2 i LMD. *Së treti*, pagesa e treguar në njoftimin me ref.nr.2073 të Ministrisë së Infrastrukturës, të datës 24 korrik 2013 duke qenë i prekur tek S. (H.) S. si person i tretë jo i autorizuar nuk ka mundur të konsiderohet i vlefshëm bazuar në Nenin 305, paragrafi 2 i LMD pasi që A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. nuk e kanë aprovuar atë apo përfituar nga kjo shumë. Në këtë fazë kompensimi i specifikuar në Vendimin Nr.

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

03/100 i QRK, të datës 12 nëntor 2012 për pronat e kontestueshme nuk është dëshmuar si e paguar në mënyrë të vlefshme në ndonjërin nga elementet e saja në mënyrë direkte Pronarëve dhe Zotëruesve të Interesit të prekur në pajtim me Nenin 16, paragrafi 2 i LSHPP-së apo duke depozituar shumën e përgjithshme në llogari të mirëbesimit në emër të tyre në BQK në pajtim me Nenin 16, paragrafi 3 i LSHPP-së. *Në vend të tretë*, dispozita e Nenit 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së paraqet që personat që janë pronarë ose posedues të pronës nuk do të detyrohen që ta lirojnë ose dorëzojnë pronën nëse kjo është një shtëpi në mënyrë aktive e shfrytëzuar për qëllime të banimit 20 ditë kanë kaluar nga e cila kompensimi i specifikuar në Vendimin Përfundimtar është paguar në pajtim me Nenin 16 të LSHPP-së. Është vërtetuar nga dëshmia e siguruar në CN.nr.308/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë që momentalisht në shtëpinë e ndërtuar në ngastrën katastrale nr. 152-0 ZK Mazgit në katet e banueshme jetojnë katër familje, 12 persona në përgjithësi, duke përfshirë fëmijë të mitur. Pasi që kjo është një *shtëpi e shfrytëzuar për qëllime të banimit* në mungesë të pagesës së vlefshme të kompensimit për shkak të shpronësimit në pajtim me Nenin 16 të LSHPP-së, afati kohor 20 ditor i paraparë me Neni 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së për lirim të saj nuk ka filluar të rrjedh dhe nuk ka skaduar. *Në vend të katërt*, në pajtim me Nenin 20, fjalia e parë e LSHPP-së në rast të shpronësimit të një ndërtese që përdoret si vendbanim, Organi Shpronësues do t'u siguroj banorëve strehime të përkohshme për periudhën deri në katër (4) muaj pas mbarimit të periudhës 30 ditore të paraparë në Nenin 11, paragrafi 9 i LSHPP-së, përderisa nuk merren vesh ndryshe. Ky obligim mund të përmbushet duke lejuar banuesit për të banuar në shtëpinë e shpronësuar në tërësi apo në pjesë të një afati të tillë 4 muaj sipas Nenit 20, fjalia e dytë e LSHPP-së. *Ky kush shtesë juridik për lirim të shtëpive banesore të shpronësuara të përdorura si vendbanim* nuk është dëshmuar siç është e aplikueshme në lëndë – deri më tani banuesit e shtëpisë në ngastrën katastrale nr. 152-0, ZK Mazgit nuk janë siguruar me banim të përkohshëm në kundërshtim me nenin 20 të LSHPP-së. E përmendur në Njoftim me ref.nr.2073 të Ministrisë së Infrastrukturës, të datës 24 korrik 2013 është që strehimi i përkohshëm do të sigurohet në Hotelin N.T.S.H. “A” bazuar në kontratën e nënshkruar me MMPH

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

më 22 korrik 2013. Sidoqoftë, pasi që ky njoftim iu është adresuar S. (H.) S., i cili nuk ka të drejta/interesa në shtëpi në ngastrën katastrale nr.152-0, ZK Mazgit, e as *de facto* nuk jeton në atë, banuesit e kësaj shtëpie të banimit mbeten pa strehim të përkohshëm, siç është paraparë në Nenin 20 të LSHPP-së.

13. Në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1, fjalia e dytë e LSHPP-së shpronësimi i pronës së paluajtshme gjithmonë do të jetë *në mënyrë të kufizuar* duke iu nënshtruar kufizimeve, procedurave, rregullave dhe kushtet e përcaktuara në LSHPP. Ne kundërshtim me këtë në rastin aktual nuk është verifikuar një pajtueshmëri e tillë me kriteret e përmendura më lart të Neneve 10, 11, 16 dhe 20 të LSHPP-së, të gjithë në mënyrë mandatorë kanë kërkuar ndryshim të pronësisë në ndërtesën/shtëpinë në ngastrën katastrale nr.152-0, ZK Mazgit dhe dorëzimi i posedimit të saj Organit Shpronësues. Nën këto rrethana, masa e propozuar e sigurisë është e arsyetuar sipas Nenit 297, paragrafi 1, pika b) LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ për të neutralizuar rrezikun e pashmangshëm që shtëpia të rrënohet në ditët vijuese kështu në mënyrë të pakthyeshme duke ndryshuar gjendjen ekzistuese të kësaj prone të banimit edhe pse kushtet ligjore, në mënyrë imperative të parapara nga Nenet 10, 11, 16 dhe 20 të LSHPP-së, për shpronësim të saj dhe lirimi nuk janë përmbushur dhe në mënyrë të pavolitshme duke prekur të drejtat e palëve të cilat propozojnë këtë siguri si pronarë ose posedues dhe apo banues të saj.

14. Në bazë të informatave të marra në parashtrësia të shumta të A. S., H. S., B. S., N. S. dhe D. S. paraqitur institucioneve të ndryshme publike dhe duke paraqitur në lëndë, të gjitha përpjekjet e tyre për të diskutuar çështjet në lidhje me shpronësimin e ngastrave katastrale nr.149-0, nr.150 dhe nr.152-0 në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në muajt e fundit ka dështuar. Pa një rregullim të tillë të pasojave të shpronësimit nga fillimi i këtij viti ka pasur qasje të palejueshme të Kompanisë Ndërtimore “B-E” në pronat me tentime të shumta për të detyruar paditësit për t’i liruar ato. Në disa raste burrat e familjes S. ishin ftuar në stacionin policor në Obiliq për të dhënë deklarata për mos dorëzim të pronave. Ka pasur gjithashtu incidente që kanë përfunduar me arrestime, ai i fundit duke qenë më 25

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

korrik 2013. Shtëpia është vendosur nën vëzhgim policor. Në ndërkohë, punët ndërtimore në këtë sektor të auto udhës janë duke vazhduar në kapacitet të plotë 24 orësh; me staf dhe makineri të shumtë. Për shkak të këtyre zhvillimeve, për muaj familja është vënë nën presion ekstrem psikologjik, duke u ballafaquar me pasiguri të plotë në shtëpi të tyre. Ndonëse në mënyrë të gabuar e adresuar dhe dorëzuar, Njoftimi me ref.nr.2073 të Ministrisë së Infrastrukturës, të datës 24 korrik 2013 është tregues që rrënimi i shtëpisë familjare është në ardhje. Lidhjet e palëve janë aq të keqësuar që rreziku i eskalimit të ardhshëm me konflikte te reja serioze janë të pashmangshme. Për këto arsye, gjykata konstaton që kushti i Nenit 306, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ është plotësuar për të vendosur propozimin e sigurisë, të datës 11 korrik 2013 pa njoftim paraprak të palëve të kundërta apo seancë përgatitore – këtë kërkesë sipas Nenit 304 të LPK në lidhje me Nenin 3 bazohet në pretendimet e besueshme që ndalesa e përkohshme e rrënitit të shtëpisë është e bazuar dhe urgjente, dhe që duke vepruar ndryshe do të nxjerrte qëllimin e pavlerë të sigurisë.

15. Bazuar në këto shqyrtime, masa e propozuar e sigurisë do të caktohet në pajtim me Nenin 297, paragrafi 1, Neni 300, pika c), Neni 301, pika a) dhe Neni 306, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ – kundër paditësi do të ndalohet për të rrënuar shtëpinë në ngastrën katastrale nr. 152-0, ZK Mazgit për të ruajtur gjendjen ekzistuese dhe për të ndaluar çdo shkelje të të drejtën pronësore dhe të drejtën adekuate të kompensimit të shpronësimit, e garantuar me Nenin 46 të Kushtetutës dhe Neni 1 i Protokollit të parë (1) të KEDNJ, si dhe të drejtën në shtëpi, e mbrojtur me Nenin 36 të Kushtetutës dhe Neni 8 të KEDNJ, për pronarin/pronarët, poseduesin/poseduesit dhe banuesit e kësaj shtëpie të banimit dhe/apo çdo efekt tjetër të kundërt dhe/apo dëme. Sidoqoftë, rrënimi mund të ndalohet vetëm nga gjykata përderisa të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në Nenet 10, 11, 16 dhe 20 të LSHPP-së, të analizuara në paragrafin 12 të arsyetimit dhe cekur në pikat III të dispozitivit të këtij aktvendimi, janë përmbushur në mënyrë të rregullt. Pas një përmbushje të tillë, kjo shtëpi/ndërtesë e banimit duhet të konsiderohet e shpronësuar, kështu e bartur nga pronësia private në shtetërore në pajtim me Nenin 4, paragrafi 5 dhe Neni 26 i

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

LSHPP-së me lirim e saj duke qe do të skadojë pas 20 ditëve të afatit kohor të të paraparë nga Neni 11, paragrafi 9, nën paragrafi 1 i LSHPP-së dhe dispozita e strehimit të përkohshëm sipas Nenit 20 të LSHPP-së me të drejtë të Organit Shpronësues për të marrë posedimin e tij në pajtim me Nenin 25 të LSHPP-së. Masa e sigurisë së përkohshme mund të caktohet vetëm me këtë kohëzgjatje duke pasur parasysh kufijtë e paraparë nga Neni 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së – norma në mënyrë të qartë deklaron që ankesa kundër Vendimit Përfundimtar sipas Nenit 36, paragrafi 1 i LSHPP-së, si dhe ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë sipas nenit 36, paragrafi 7 i LSHPP-së nuk do të ketë fuqi në efikasitetin e vendimit dhe në fuqitë e Organit Shpronësues për të vazhduar me zbatimin e tij. Ky kufizim i Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së mbizotëron mbi çdo dispozitë konfliktuoze të çdo ligji tjetër procedural sipas nenit 39, paragrafi 1, fjalia e dytë e LSHPP-së. Si pasojë e kufizimit të Nenit 36, paragrafi 8 i LSHPP-së dhe epërsinë mbi dispozitat e Kapitullit XXI të LPK, Gjykata është e autorizuar të ndal zbatimin e Vendimit Përfundimtar të kundërshtuar duke ndaluar rrënimin e shtëpisë në ngastrën katastrale nr. 152-0, ZK Mazgit vetëm përderisa të gjitha kushtet e siguruara për zbatimin e ligjit të njëjtë, të ashtuquajturat Nenet 11, 16 dhe 20 të LSHPP-së të jenë plotësuar për këtë pronë të banimit. Në të kundërtën, gjykata nuk mund të autorizoj ndonjë masë të sigurisë përveç këtij kufizimi pasi që kjo do të ndal zbatimin e këtij Vendimi përfundimtar në kundërshtim të drejtpërdrejt me Nenin 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së, e cila përjashton çdo ndikim të procedurës aktuale mbi efikasitetin e saj, përfshirë pezullimin të drejtpërdrejt apo të tërthortë dhe pa kushte garanton fuqitë e Organit Shpronësues të vazhdojë me zbatimin e tij për realizim të projektit kombëtar të infrastrukturës në interes të përgjithshëm. Duke qenë në pajtim me kufijtë e Nenit 3, paragrafi 1, fjalia e dytë dhe Neni 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së, gjykata e ndalon rrënimin e ndërtesës së banimit në ngastrën katastrale nr.152-0 ZK Mazgit me kohëzgjatje përderisa kushtet e aplikueshme të përcaktuara nga ligji i njëjtë për zbatim të Vendimit Nr.03/100, të datës 12 nëntor 2012 në pjesën përkatëse janë të dëshmuara si të plotësuar në mënyrë të rregullt në lëndë.



**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

16. Propozimi i sigurisë së datës 11 korrik 2013 do të refuzohet në pjesën mbetëse duke kërkuar kohëzgjatje, më gjatë sesa ai i urdhëruari. *Në vend të parë*, jo i arsyetuar është caktimi i tij *përderisa të kryhet ekspertiza e punës për 'vlerësim real' të ndërtesës/shtëpisë së banimit*. Një ekspertizë e tillë tashmë është caktuar në CN.nr.308/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë me konstatim me shkrim dhe mendim të paraqitur në lëndë, dhe ekzaminimi i ekspertit në seancën e datës 25 qershor 2013. Pasi që kjo dëshmi tashmë është siguruar në pajtim me Nenin 385, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, do të përfshihet në këtë lëndë sipas Nenit 385, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ pa pasur nevojë të administrohet sërish. *Mbledhjet e kaluara të kësaj dëshmie më 25 korrik 2013 së këndejmi nuk ka mundur të përcaktoj afatin e ardhshëm për sigurinë e caktuar më 30 korrik 2013 e më tutje. Në vend të dytë*, rrënimi i shtëpisë nuk ka mundur të ndalohet përderisa të bëhet *matjet e sakta të ngastrave katastrale nr. 149-0, nr. 150-0 dhe nr. 152-0 në këtë lëndë*, siç është kërkuar më tutje në petitum të propozimit, të datës 11 korrik 2013. *Së pari, sipërfaqet e tyre të përgjithshme janë të regjistruara zyrtarisht në kadastër, të dëshmuara në Certifikatë të Drejtave të Pronës së Paluajtshme Nr. UL-72614046-00002, ZK Mazgit si 1 262 41 775 m<sup>2</sup>, dhe 2 144 m<sup>2</sup>, respektivisht dhe nuk ka mundur të shqyrtohet sërish dhe të ndryshohet në këtë procedurë pasi që çështja e saj lëndore është e kufizuar në rregullimin e shumës së kompensimit vetëm në pajtim me Nenin 36, paragrafi 1 i LSHPP-së dhe Neni 215 i LPJ. Së dyti, pjesët e ngastrës katastrale nr. 149-0, nr. 150-0 dhe nr. 152-0, të shpronësuara me Vendimin Nr. 03/100 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 12 nëntor 2012 janë me sipërfaqe prej 775 m<sup>2</sup>, 7 655 m<sup>2</sup>, dhe 725 m<sup>2</sup>, respektivisht, të treguara në Shtojcë të saj në pajtim me Nenin 11, paragrafi 4.3.2.2 të LSHPP-së. Gjykata nuk është e autorizuar të rishikoj këto pjesë të shpronësuara, së këndejmi të gjitha kërkesat dëshmuese për matjen e tyre në procedurën aktuale gjyqësore mund të jetë vetëm e palejueshme. Së treti, rrënimi i ndërtesës nuk mund të ndalohet përderisa një matje e tillë e ngastrave katastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, si vlerësim i ndërtesës/shtëpisë në fakt dhe ligjërisht nuk varet në vlerësimin e tokës në kufijtë e saj. Në vend të tretë, siguria nuk do të urdhërohet përderisa vlerësimi i drejtë i këtyre ngastrave katastrale duke u bazuar në*

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

*çmimin e tyre të tregut* siç është propozuar përfundimisht në petitem. Ky afat i lidhur me vlerësimin e terrenit në procedurë gjyqësore nuk varet fare në masën e zgjedhur për mos rrënim të ndërtesës. *Së dyti*, realizimi i punëve ndërtimore në autostradë në sipërfaqet e shpronësuara të ngastrave katastrale nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0 nuk do të bëj të pamundshme. E as në mënyrë substanciale të pengoj vlerësimin në ngastrat e prekura të tokës përveç ndërtesës/shtëpisë. Në rast të mospërputhjeve të mundshme ndërmjet pjesëve zyrtarisht të shpronësuara të tokës me ato *de facto* të shfrytëzuara për ndërtim nuk mund të vendoset në këtë procedurë të kufizuar nga Neni 36, paragrafi 1 i LSHPP-së në fushëveprimin e tij për të barazuar kompensimin *de jure* për pronat e shpronësuara vetëm. Asnjë interes i sigurisë nuk është i arsyetuar dhe asnjë masë e propozuar për ruajtje të instalimeve, pjesët aksesore dhe frutat e saj dhe/apo për identifikim të dëmeve drejtpërdrejt të demonstruara të bëra në procesin e shpronësimit, që gjenden në pronat nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, në bazë të sigurimit të aplikimit të ardhshëm të Nenit 15, paragrafi 2 i LSHPP-së. Asnjë interes i sigurisë nuk është i arsyetuar dhe asnjë masë e propozuar për ruajtje të instalimeve, pjesëve aksesore dhe frutave të saj dhe/apo për identifikim dhe demonstrim direkt të dëmeve të shkaktuara në procesin e shpronësimit, që gjenden në ngastrat nr.149-0, nr.150-0 dhe nr.152-0, duke pasur parasysh aplikimin e ardhshëm të nenit 15, paragrafi 2 i LSHPP-së. *Së treti*, kompensimi i shpronësimit të kundërshtuar në këtë lëndë ka mundur zyrtarisht të kualifikohet si “*reale*” që do të thotë bazuar në vlerën e tregut të pronave në pajtim me Nenin 15, paragrafi 1 i LSHPP-së dhe legjislacioni shtesë sipas Nenit 15, paragrafi 6 i LSHPP-së, vetëm përmes aktgjykimit përfundimtar të nxjerrë në shkallë të parë sipas Nenit 36, paragrafi 6 i LSHPP-së apo në shkallë të dytë sipas Nenit 36, paragrafi 7 LSHPP-së. Sidoqoftë, siguria nuk mund të urdhërohet përderisa një fund i tillë i kontestit mbi kompensimin e shpronësimit pasi që kjo do të thotë zbatimi i vendimit Nr. 03/100, të datës 12 nëntor 2012 të pezullohet për një afat të pacaktuar në shkelje të Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së që qartë ndalon çdo ndikim të shkallës së parë dhe të dytë të procedurës gjyqësore sipas nenit 36, paragrafët 1 – 7 mbi efikasitetin në këtë Vendim Përfundimtar mbi Shpronësimin, përfshirë pezullimin e pjesshëm përmes sigurisë. Prandaj zbatimi i saj ka mundur të

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**

shtyhet për ndërtesën e banimit në ngastrën katastrale nr. 152-0, ZK Mazgit vetëm brenda kufijve të Nenit 36, paragrafi 8, fjalia e parë e LSHPP-së duke ndaluar rrënimin e tij deri në përmbushje të gjitha kushteve të përcaktuara në nenet 10, 11, 16, 20, 25 dhe 26 të LSHPP-së për zbatim të Vendimit Nr. 03/100 të datës 12 nëntor 2012 me shpronësim të pronësisë private mbi të dhe dorëzim të posedimit të saj Organit Shpronësues.

18. Për të gjitha këto arsye, propozimi sipas Nenit 304 të LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ, të datës 11 korrik 2013 miratohet pjesërisht dhe pjesërisht refuzohet.

19. Kërkesa e propozuesve të kompensohet nga kundër paditësit për shpenzimet e bëra gjatë rrjedhës së procedurës së sigurisë në pajtim me Nenin 314, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ nuk ka mundur të vendoset në këtë aktvendim pa specifikimin e tyre dhe dëshminë e paraqitur për shpenzime të tilla procedurale sipas Nenit 463, paragrafët 1 – 2 të LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ. Andaj, kompenzimi i shpenzimeve të shfaqura për shqiptimin dhe zbatimin e masës së sigurimit do të mbetet që të vendoset nga aktgjykim sipas Nenit 314, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ.

20. Ky aktvendim dorëzohet menjëherë kundër propozuesve për përgjigje brenda një afati prej 3 ditëve me deklaratë mbi arsyet për kundërshtim të sigurisë dhe kërkesës për caktim të seancës në të brenda 3 ditëve të ardhshme në pajtim me Nenin 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ.

21. Për të përgatitur seancën në lëndët e bashkuara, propozimi në CN.nr. 249/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe ankesa në CN.nr. 467/13 të Gjykatës Themelore në Prishtinë do të dorëzohet në 5 kopje me të gjitha bashkëlidhjet e tyre drejtuar kundër propozuesve përmes Ministrisë së Drejtësisë si përfaqësues të tyre ligjor për përgjigje brenda 30 ditëve në pajtim me Nenin 36, paragrafët 4 dhe 5 të LSHPP-së. Në të njëjtën kohë dosja e shpronësimit të plotë administrativ do të kërkohet në pajtim me nenin 216, paragrafi 1, Neni 218, paragrafi 1 i LPJ dhe Neni 332 të LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ. Palëve do të jepet afat kohor për të specifikuar të gjitha dëshmitë që

**AKTVENDIMI CN.nr.249/13 & CN.nr.467/13 I GJYKATËS THEMELORE TË  
PRISHTINËS, DATA 30.07.2013**


duhet të sigurohen me urgjencë në procedurë aktuale në pajtim me Nenin 379 – 381 të LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ.

Duke pasur parasysh arsyetimin e sipërpërmendur është vendosur si në dispozitiv.

**MJETET JURIDIKE:** Asnjë ankesë e veçantë nuk lejohet kundër pikës I të këtij aktvendimi sipas Nenit 408, paragrafi 5 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ.

Kundër propozuesit që refuzojnë sigurinë mund të parashtrojnë kundërshtime në pikat II – IV të këtij aktvendimi në pajtim me Nenin 306, paragrafi 2 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë brenda tre (3) ditëve nga data e dorëzimit të tij. Nuk lejohet ankesë kundër pikave II – IV të aktvendimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë sipas nenit 310, paragrafi 5 i LPK.

Të gjitha palët mund të parashtrojnë ankesë kundër pikës V të këtij Aktvendimi në pajtim me Nenin 310, paragrafi 1 i LPK në lidhje me Nenin 3 të LPJ drejtuar Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore në Prishtinë brenda shtatë (7) ditëve nga data e dorëzimit.



**GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS**  
**CN.nr.249/2013 & CN.nr.467/2013 më 30 korrik 2013**

**GJYQTARJA E EULEX-IT ROSITZA BUZOVA**

*Përgatitur në Anglishte si gjuhë zyrtare në pajtim me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndës dhe Caktimin e Lëndës Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.*